



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA ROSKOVEC
KOORDINATORI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT

Nr. 5518/2 prot.

Roskovec, më 20.082021

Lënda: Kthim përgjigje kërkesës për informacion mbi investimet e zhvilluara në fshatin Luar në kuadër të projektit “100 fshatrat”.

ZNJ. FJORALBA SINORUKA

Tiranë

Në përgjigje të kërkesës suaj, ardhur elektronikisht në adresën e e-mailit të Koordinatorit për të Drejtën e Informimit dhe protokolluar në institucionin tonë me nr.5518, datë 10.08.2021, ju informojmë se:

Kërkesa juaj është trajtuar nga Sektori i Zbatueshmërisë së Investimeve dhe Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Bashkia Roskovec, ku sipas informacionit shkresor me nr. 5518/1, datë 19.08.2021, investimet që janë zhvilluar në fshatin Luar në kuadër të projektit “100 fshatrat” janë:

1. “Ndërtimi i parkut agro-turistik dhe rehabilitimi i rrugës hyrëse, fshati Luar”
2. “Rikonstruksion i rrugës Kuman-Luar-Vidhishtë”
3. “Rikonstruksion i rrugës “Shkolla-Kerranjakët, fshati Luar, b=4m+2*0.5m bankinë”.

Bashkëlidhur, po ju dërgojmë:

- Shkresën nr. 5518/1, datë 19.08.2021, informacion mbi investimet që janë zhvilluar në fshatin Luar në kuadër të projektit “100 fshatrat” si dhe kopje të marrëveshjes dhe kontratave të lidhura për këto investime.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin,

KRYETARI

Majlinda Bufi

NË MUNGESË DHE ME URDHËR

ZËVENDËSKRYETARI





REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA ROSKOVEC
SEKTORI ZBATUESHMËRIA E INVESTIMEVE

Nr. 5518/1 prot

Roskovec, më 19.08 2021

Lënda: Informacion mbi investimet që janë zhvilluar në fshatin Luar në kuadër të projektit “100 fshatrat”

KORDINATORIT PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT

Roskovec

Në kuadër të projektit “Rivitalizimi Urban i zonave me potencial të lartë turistik në rajonin 3 dhe 4. Ju informojmë se:

Investimet që janë realizuar në fshatin Luar në kuadër të projektit ‘100 fshatrat’ janë:

1. “Ndërtim i parkut Agro –Turistik dhe Rehabilitim i rrugës hyrëse, Fshati Luar.
Projekti është tenderuar nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit.
Operatori Ekonomik : “ED Konstruksion ,GPG Company & Shëndelli Shpk vlera e projektit 79,766,390 leke. Punimet kanë përfunduar dhe janë në proces marrje në dorëzim.
2. Rikonstruksion i rrugës Kuman-Luar- Vidhishtë me asfalt, punimet janë kryer nga firma “Boshnjaku B” Investitori Bashkia Roskovec. Vlera e projektit 37,668,893 leke.
3. Rikonstruksion i rrugës shkolla Kerranjaket, fshati Luar, b=4m+2*0.5m (bankinë), Investitori për këtë objekt është Bashkia Roskovec, Firma fituese “Boshnjaku –B-shpk” vlera e projektit është 7,289,911. Kontrata është lidhur në datë 11.03.2019 dhe punimet kanë përfunduar 3 (tre) muaj nga data e fillimit të punimeve.

Bashkëlidhur po ju dërgojme kontratat e punëve publike + marrëveshjen e investimit” Ndërtim i parkut agro –turistik dhe rehabilitim i rrugës hyëse fshati Luar !

Konceptoi: E. Metushi
R. Hazizaj





REPUBLIKA E SHQIPERISE
AUTORITETI KONTRAKTOR
BASHKIA ROSKOVEC

Nr. 4482 Prot.

Datë 02 . 11 .2018

KONTRATE PUNE PUBLIKE

ME OBJEKT:

"Rikonstruksioni i rruges Kuman - Luar - Vidhishte, Pr 1900- 4110, L= 2210ml, b=4+2x0.5m "

PALËT:

AUTORITETI KONTRAKTOR :

BASHKIA ROSKOVEC

KONTRAKTOR:

"Pese Vellezerit" Sh.p.k. & "Boshnjaku B" Sh.p.k



Neni 1:

Palet kontraktuese

BASHKIA ROSKOVEC, e perfaqesuar nga Kryetari Znj.Majlinda BUFI, ne vijim i quajtur Autoriteti Kontraktor.

Dhe

B.O.: “Pese Vellezerit” Sh.p.k.& “Boshnjaku B” Sh.p.k., perfaqesuar nga Administratori i shoqerise Z. Shkelqim Dulla dhe Z. Bashkim Dulla, ne vijim i quajtur Kontraktori.

Shoqeria: “Pese Vellezerit” Sh.p.k., me NIPT L22925402C, me seli ne adresen: L. “Bishanak”, Rr. “Skëndërbeu”, pranë karb. “Bolv Oil”, Fier.

Shoqeria: “Boshnjaku B” Sh.p.k, me NIPT k72627402H, me seli ne adresen: L. “Bishanak”, Rr. “Skëndërbeu”, pranë karb. “Bolv Oil”, Fier.

Neni 2:

Objekti i kontrates

Kjo kontrate lidhet per realizimin e punimeve me objekt “Rikonstruksioni i rruges Kuman - Luar - Vidhishte, Pr 1900- 4110, L= 2210ml, b=4+2x0.5m”, ne BASHKIA ROSKOVEC.

Neni 3:

Vlera e kontrates

Vlera totale e objektit eshte 31 390 744 (tridhjete e njemilion e treqind e nentedhjetemije shtateqind e shtatedhjete e kater) leke pa tvsh dhe 37 668 893 (tridhjete e shtatemilion gjashteqind e gjashtedhjete e tetemije e teteqind e nentedhjete e tre) leke me tvsh, e fituar nga Kontraktori ne tenderin e organizuar nga Autoriteti Kontraktor BASHKIA ROSKOVEC.

Financimi i ndare si me poshte:

-Financimi per vitin 2018 nga Bashkia: 4 933 718 leke pa tvsh, 5 920 462 leke me tvsh

-Financimi per vitin 2019 nga Bashkia : 26 457 026 leke pa tvsh, 31 748 431 leke me tvsh

Neni 4:

Përkufizime

- “Preventiv total” do të thotë volumet e punes te dhena ne projekt te cilat jane orientuese, plotesuar me cmimin total të përcaktuar që është pjesë e Ofertes në një kontratë me çelsa ne dore.
- “Preventiv per njesi” do të thotë volumet e punes te dhena ne projekt shoqeruar me cmimet per njesi te pandryshuara që janë pjesë e Ofertes në një kontratë me punime ne matje.
- “Afati i realizimit te punimeve” do të thotë data që Punët duhet të perfundojnë siç është shprehur në Grafikon për realizimin Punimeve , e vertetuar nga enti prokurues.
- “Kontratë” do të thotë marrëveshja e shkruar e lidhur midis Autoritetit Kontraktor dhe kontraktorit që përbëhet nga dokumentat e tenderit duke përfshirë KPK dhe KVK, të gjitha bashkangjijtjet dhe formularët e plotësuar dhe të gjitha dokumentat e tjera që përfshihen në referimin e çdo dokumenti.
- “Çmimi kontrate” do të thotë çmimi që i paguhet kontraktorit sipas kontratës për zbatimin e plotë dhe të përpiktë të detyrimeve të tij kontratore.
- “Realizimi i punimeve” do të thotë data e vërtetuar nga Autoriteti Kontraktor se Punët janë mbaruar.
- “Defekt” do të thotë çdo pjesë e Punimeve e paperfunduar në përputhje me kontratën.
- “Data e hyrjes” do të thotë data që Autoriteti Kontraktor lejon kontraktorin në kantier.



- "Data e fillimit" është përfshirë në Të dhënat e kontratës. Ajo është data kur Sipërmarrësi do të fillojë punimet e ndërtimit.
- "Pajisje" do të thotë makineritë dhe veglat e kontraktorit të sjella përkohësisht në kantiër për realizimin e Ndërtimeve.
- "Materiale" do të thotë të gjitha furnizimet, duke përfshirë ato të konsumit, të përdorura nga kontraktori për kryerjen e punimeve.
- "Objekt i kontratës" do të thotë të gjitha Punët që kontraktori do të sigurojë sipas kushteve të kontratës.
- "Palë(t)" do të thotë nënshkruesit e kontratës.
- "Drejtues projekti" do të thotë personi i emëruar nga Autoriteti Kontraktor që është përgjegjës për administrimin e kontratës për Autoritetin Kontraktor.
- "Autoritet Kontraktor" do të thotë Autoriteti Kontraktor që është pjesë e kësaj kontrate dhe që kontraktori punët objekt i kësaj kontrate. Ky term kudo që përdoret ka kuptim të njëjtë me atë të perkufizuar në ligj.
- "Kantiër" do të thotë vendi fizik i Punimeve.
- "Raport i inspektimit të kantiërit" do të thotë dokumentat e përfshira në dokumentat e tenderit që pasqyrojnë informacion faktik dhe të interpretuar rreth kushteve të sipërfaqes dhe nëntokës së kantiërit.
- "Nënkontraktues" do të thotë çdo person fizik ose ligjor ose kombinim i mësipërm, që furnizon Punët, materialet ose pajisjet për ose në emër të kontraktorit.
- "Kontraktori" do të thotë personi fizik ose juridik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate siguron Punimet.
- "Standarte Teknike" do të thotë specifikimet e aprovuara nga një trup i posaçëm standartzimi për zbatimin e vazhdueshëm ose të përsëritur. Standarte të tilla përdoren si rregulla, rregullore ose perkufizim të karakteristikave për të siguruar se materialet dhe shërbimet e procesuara i përgjigjen qëllimit.
- "Ngritja e kantiërit" do të thotë punimet e ndërtimit të përkohshme, të ndërtuara e instaluar, që janë të nevojshme për zbatimin e punimeve të ndërtimit.
- "Punime" do të thotë ajo që Autoriteti Kontraktor i kërkon nga kontraktori të gërmojë, ndërtojë, riparojë, rinovojë ose instalojë siç parashikohet në dokumentat e tenderit duke përfshirë shërbimet në lidhje me to, gjithashtu të perkufizuara në dokumentat e tenderit.

Neni 5 :

Data e nënshkrimit të kontratës, fillimit të punimeve dhe afati për perfundimin e punimeve

Sot me datë __. __. 2018 nënshkruhet kjo kontratë sipërmarrje ndërmjet Autoritetit Kontraktor dhe Kontraktorit. Data e fillimit të punimeve menjëherë pas lidhjes së kontratës së mbikqyresit të punimeve dhe lirimit të sheshit të ndërtimit. Afati për perfundimin e punimeve është **15 (pesëmbëdhjetë) muaj nga data e fillimit të punimeve.**

Neni 6:

Garancia e punimeve

Garancia e punimeve është 1 (një) vit. Periudha e garancisë së punimeve fillon nga data e kolaudimit të punimeve dhe përfundon brenda 1 (një) viti. Në përfundim të periudhës së garancisë së punimeve: Autoriteti Kontraktor, Kontraktori, Mbikqyresi i Punimeve dhe Kolaudatori bëjnë kontrollin përfundimtar të punimeve dhe nëse nuk ka defekte të punimeve, lëshojnë Certifikatën Përfundimtare të Marrjes në Dorezim të Punimeve.

Neni 7



Perfaqesuesit e Invesitorit

Nga ana e Autoritetit Kontraktor do te vendosen si perfaqesues prane Kontraktorit persona te autorizuar prej Kryetarit te Autoritetit Kontraktor te cilet do te jene me cilesine e meposhtme:

Drejtuues i Punimeve, _____ me Licence _____.

Mbikqyres i Punimeve, _____, me Licence _____.

Neni 8:

Hartimi i Kontratës

Njoftimi i ofertes fituese, sherbeu për hartimin e kontratës midis palëve.

Ekzistenca e kontratës do të konfirmohet me nënshkrimin e dokumentit të kontratës duke sanksionuar të gjitha marrveshjet midis palëve.

Neni 9:

Praktikat e Korrupuara, Konflikti i Interesit dhe Kontrolli i Procesverbaleve

Autoriteti Kontraktor mund t'i kërkojë gjykatës të deklarojë të paligjshme kontratën nëse zbulon se Kontraktori ka kryer veprime të korrupuara. Veprimet e korrupuara përfshijnë veprimet e përshkruara në dispozitat e Ligjit mbi Prokurimin Publik.

Neni 10:

Informacioni Konfidencial

Autoriteti Kontraktor dhe Kontraktori duhet të mbajnë në kofidencë të gjitha dokumentat, të dhënat dhe informacionet e tjera të dhëna nga pala tjetër në lidhje me kontratën.

Kontraktori mund t'i japë nënkontraktorit dokumenta të tilla, të dhëna ose informacione të tjera që merr nga Autoriteti Kontraktor deri në masën e kërkuar që nënkontraktorin të zbatojë punën e tij sipas kontratës.

Neni 11:


Prona Intelektuale

Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, të gjitha të drejtat e pronës intelektuale të siguruar nga kontraktori gjatë zbatimit të kontratës do t'i përkasin Autoritetit Kontraktor i cili mund t'i përdorë ato sipas gjykimit të tij.

Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, kontraktori, pas përfundimit të kontratës, duhet t'i dorëzojë Autoritetit Kontraktor të gjitha raportet dhe të dhënat si hartat, diagramët, skicimet, specifikimet, planet, statistikat, llogaritjet dhe regjistrat mbështetës ose materialet e fituara, mbledhura ose përgatitura nga kontraktori gjatë zbatimit të kontratës. Kontraktori mund të mbajë kopje të këtyre dokumentave dhe të dhënave, po nuk duhet t'i përdori për qëllime që s'kanë lidhje me kontratën pa leje paraprake me shkrim nga Autoriteti Kontraktor.

Kontraktori duhet të garantojë Autoritetin Kontraktor zhveshjen nga përgjegjësia për shkelje të të drejtave të pronës intelektuale, që mund të dalin nga përdorimi i materialeve, skicave ose çdo prone tjetër sipas kontratës.

Në rast se ngrihet ndonjë pretendim ose padi kundër Autoritetit Kontraktor në lidhje me ndonjë shkelje të pronës intelektuale të shkaktuar nga zbatimi i kontratës ose nga përdorimi i materialeve, skicave ose çdo prone tjetër të mbrojtur e të furnizuar sipas kontratës, kontraktori duhet t'i japë Autoritetit Kontraktor të gjitha provat dhe informacionin në posedim të kontraktorit që kanë të bëjnë me këtë padi apo pretendim.



Neni 12:

Origjina e Materialeve

Nuk ka asnjë kufizim për kombësinë e origjinës së materialeve, përveç atyre që mund të jenë përcaktuar në ndonjë Rezolutë të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara.

Neni 13:

Vendimet e Drejtuesit të Projektit

Drejtuesi i projektit do të vendosë për çështjet e kontratës midis kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor

Drejtuesi i Projektit mund të delegojë ndonjë nga detyrat dhe përgjegjësitë e tij tek të tjerët përveç zgjidhjen e mosmarrveshjeve dhe konflikteve. Drejtuesi i projektit duhet të njoftojë kontraktorin për delegimet e bëra apo të revokuara.

Neni 14:

Komunikimi

Çdo komunikim midis palëve duhet të bëhet me shkrim.

Neni 15:

Përgjegjësia e Autoritetit Kontraktor

Autoriteti Kontraktor ka përgjegjësi të kompensojë kontraktorin për dëmtime të pajisjeve të kontraktorit deri në masën që lidhet me veprime me faj të Autoritetit Kontraktor ose të projekteve të Autoritetit Kontraktor.

Neni 16:

Kontraktori që Kryen Punimet

Kontraktori duhet të kryejë dhe mbarojë Punimet në përputhje me specifikimet teknike të paraqitura në dokumentat e tenderit.

Kontraktori nuk mban përgjegjësi për gabimet në projekt, të dhëna, planimetri ose aspekte të tjera të specifikimeve teknike, të dhëna nga Autoriteti Kontraktor.

Kodet dhe standartet që do zbatohen do të jenë të shprehura në dokumentat e tenderit. Nëse gjatë ekzekutimit të kontratës, ka ndryshime në zbatimin e kodeve ose standarteve, këto ndryshime do të zbatohen vetëm pasi të jenë aprovuar nga Autoriteti Kontraktor.

Neni 17:

Ekzekutimi i Punimeve


Kontraktori duhet të fillojë zbatimin e kontratës menjëher pas nenshkrimit të saj dhe lirimit të sheshit të ndërtimit dhe duhet t'i mbarojë Punët brenda Afatit të Mbarimit **15 (pesëmbëdhjete) muaj nga data e fillimit të punimeve.**

Neni 18:

Ngritja e Kantierit

Kontraktori mban përgjegjësi për projektin e Ngritjes së Kantierit.

Kontraktori duhet të paraqesë të gjitha planet për Ngritjen e Kantierit tek drejtuesi i projektit për shqyrtimin dhe miratimin e tij.



Neni 19:

Sigurimi Teknik dhe Mjedisor

Kontraktori do të mbajë përgjegjësi për sigurinë e të gjitha aktivitetëve në kantier.

Kontraktori do të sigurojë kantierin në mënyrë të tillë që të minimizojë dëmtimet e mjedisit. Ai duhet të kursejë energjinë, ujin dhe burime të tjera, të reduktojë humbjen dhe të minimizojë përdorimin e substancave varfëruese të ozonit, çlirimin e gazrave, Lëndët e përbëra organike të rezikshme dhe substanca të tjera, që dëmtojnë shëndetin dhe mjedisin.

Neni 20:

Zbulimet

Çdo gjë me interes historik ose me vlerë të konsiderueshme e zbuluar papritur në kantier do të deklarohet për të vepruar konform legjislacionit në fuqi. Kontraktori duhet të njoftojë drejtuesin e projektit për ndonjë zbulim të tillë dhe të ndjekë udhëzimet e drejtuesit të projektit për procedurën e administrimit të objekteve.

Neni 21:

Disponimi i Kantierit

Autoriteti Kontraktor duhet t'i japi të drejtën e disponimit të kantierit kontraktorit në datën e hyrjes të shprehur në dokumentat e tenderit. Nëse disponimi i ndonjë pjese të kantierit nuk jepet brenda datës së hyrjes për kantierin ose asaj pjese të kantierit siç parashikohet në dokumentat e tenderit, do të konsiderohet se Autoriteti Kontraktor ka vonuar fillimin e zbatimit të kontratës, dhe kontraktori i lind e drejta të kërkojë amendimin e kontratës në lidhje me shtyrjen e Afatit të Mbarimit. Autoriteti Kontraktor dhe kontraktori do të mbajnë procesverbal për datën e hyrjes.

Neni 22:

Raportimi i Grafikut të Zbatimit

Menjëherë pas lidhjes së kontratës, kontraktori duhet t'i paraqesë drejtuesit të projektit një program plani që tregon metodat e përgjithshme, rregullimet, porositë, afatet dhe rrugët kritike për aktivitetet e Punimeve .

Në intervale të skeduar rregullisht siç është aprovuar nga drejtuesi i projektit, kontraktori duhet të përgatisë raportime duke treguar progresin e arritur në çdo aktivitet dhe efektet e progresit në punën e mbetur, duke përfshirë çdo ndryshim në sekuencën e aktivitetëve.

Neni 23:

Paralajmërimi në Kohë

Kontraktori duhet të paralajmërojë drejtuesin e projektit sa më shpejt të jetë e mundur për ngjarje dhe rrethana specifike që mund të ndodhin në të ardhmen apo që mund të ndikojnë negativisht në zbatimin e kontratës, duke përfshirë cilësinë e punës dhe vonesën në afate.

Neni 24:

Kontrolli i Cilësisë

Kontraktori do të jetë plotësisht përgjegjës për kontrollin e cilësisë dhe zbatimin e kontratës.

Drejtuesi i projektit duhet të kontrollojë punën e kontraktorit dhe të njoftojë kontraktorin për defekte që mund të jenë gjetur.

Sa herë që të jepet njoftimi për defekte, kontraktori duhet të korrigjojë defektin brenda afatit të parashikuar në njoftim.



Neni 25:

Defektet e Pakorrigjuara

Nëse kontraktori nuk e ka korrigjuar një defekt brenda kohës së specifikuar në njoftimin për defektin nga drejtuesi i projektit, drejtuesi i projektit do të llogarisë koston e korrigjimit të defektit dhe kjo shumë do të mbahet nga çdo pagesë që i duhet bërë kontraktorit deri sa defekti të korrigjohet. Dështimi për të korrigjuar defektin brenda një afati të arsyeshëm përbën shkak për zgjidhje kontrate për arsye mospërmbushje në favor të Autoriteti Kontraktor.

Neni 26:

Përgjegjësitë e Autoriteti Kontraktor

Nga Afati i fillimit deri në Afatin e Realizimit të Plote, Autoriteti Kontraktor do të jetë përgjegjës për:

- (a) dëmtim personal, vdekje ose humbje apo dëmtim të pasurisë për shkak të neglizhencës ose ndërhyrjes, qoftë edhe të ligjshme nga Autoriteti Kontraktor apo nga çdo person i punësuar/kontraktuar nga Autoriteti Kontraktor, përveç kontraktorit.
- (b) dëmtim të Punimeve, materialeve dhe pajisjeve deri në atë masë që lidhet me fajin e Autoritetit Kontraktor apo me projektin e tij.

Neni 27:

Përgjegjësitë e kontraktorit

Nga Afati i fillimit deri në Afatin e Realizimit, kontraktori do të jetë përgjegjës për dëmtim personal, vdekje ose humbje apo dëmtim të pasurisë, dhe pasuri të tjera dhe që nuk mbulohen nga Autoriteti Kontraktor sipas Nenit i mesiperm.

Neni 28:

Testimet dhe Inspektimet

Kontraktori duhet të bëjë të gjitha testet dhe inspektimet e kërkuara nga dispozitat e kontratës. Kosto e këtyre testeve dhe inspektimeve duhet të financohet tërësisht nga kontraktori brenda çmimit të kontratës.

Autoriteti Kontraktor me shpenzimet e tij, ka të drejtë të ndjekë testimet dhe/ose inspektimet. Nëse materialet prodhohen ose përgatiten në vende të ndryshme nga ato të kontraktorit, kontraktori duhet të sigurojë leje për Autoritetin Kontraktor për të ndjekur këto teste dhe inspektime.

Autoriteti Kontraktor gjithashtu mund t'i kërkojë kontraktorit të bëjë teste ose inspektime shtesë të paparashikuara në kontratë por të gjykuara të nevojshme për të verifikuar se Punimet janë konform specifikimeve dhe kushteve të kontratës. Autoriteti Kontraktor do të mbajë përgjegjësi për koston e këtyre testeve. Gjithashtu, nëse këto teste ndalojnë progresin e punës së kontraktorit, Autoriteti Kontraktor do të bjerë dakort të ndryshojë grafikun.

Autoriteti Kontraktor do të refuzojë çdo Punim që nuk e kalon testimin dhe/ose inspektimin ose nuk është konform specifikimeve teknike dhe kushteve të kërkuara në zbatimin e kontratës.

As egzekutimi i testeve as inspektimi i Punimeve nuk do ta lirojë kontraktorin nga çdo garanci ose detyrim tjetër sipas kontratës.

Neni 29:

Garancitë

Kontraktori garanton se materialet e trupëzuara me Punët janë të reja, të papërdorura dhe të modeleve të fundit dhe se trupëzohen përmirësimet e fundit në projekt dhe materiale, me përjashtim kur parashikohet ndryshe në kontratë.

Me përjashtim të ndonjë parashikimi në kontratë ose nga ligji, kontraktori garanton se materialet nuk kanë defekte të shkaktuara nga ndonjë veprim ose mosveprim i kontraktorit apo të shkaktuara nga

projektimi, materialet dhe puna nën kushte normale përdorimi, për kushtet që mbizotërojnë në Shqipëri.

Neni 30:

Çmimi i Kontratës

Çmimet e kontraktorit për Punët e kryera sipas kontratës nuk duhet të ndryshojnë nga çmimet e ofruar nga kontraktori në ofertën e tij.

Neni 31:

Kushtet e Pagesës

Çmimi i kontratës, duke përfshirë edhe pagesat paraprake, duhet të paguhet siç specifikohet në kontratë.

Pagesa do të bëhet me monedhë Shqiptare.

Kontraktori ka të drejtë të marrë pagesa periodike gjatë progresit të zbatimit të projektit. Grafiku i pagesave periodike do të jetë cdo muaj. Cdo fillim muaji Kontraktori paraqet për likuidim situacionin e punimeve për muajin paraardhës.

Drejtuksi i projektit duhet të kontrollojë Punimet e ekzekutuara nga kontraktori dhe duhet të verifikojë shumën që duhet t'i paguhet kontraktorit, brenda 10 ditëve pune nga data që kontraktori paraqet komunikatën e tij tek drejtuesi i projektit.

Pagesa e periodike për Punët do të bëhet brenda 10 ditëve kalendarike nga data që progresi i grafikut të zbatimit është verifikuar nga drejtuesi i projektit.

Data e pagesës do të jetë dita që fondet xhirohen nga llogaria e Autoritetit Kontraktor.

Neni 32:

Vonesa në Bërjen e Pagesës

Kontraktori ka të drejtë të shtyj afatin e përfundimit të punimeve në rast se Autoriteti Kontraktor nuk paguan detyrimet financiare sipas situacionit të miratuar nga Mbikqyresia I Punimeve.

Shperblimi për demet e shkaktuara si rezultat i vonesës në pagesë konsiston në kamatën e arritur nga data e fillimit të vonesës së debitorit (Autoriteti Kontraktor), në monedhën zyrtare të vendit ku do të bëhet pagesa. Përqindja e kamates parashikohet me ligj. Në fund të çdo viti kamatat e arrira i shtohen shumës totale, mbi të cilën është bërë llogaritja e tyre.

Kamata ligjore paguhet pa qene i detyruar kreditori (kontraktori) të provoje ndonjë dem. Nëse kreditori (kontraktori) provon se ka pesuar një dem me të madh se kamata ligjore, debitori (Autoriteti Kontraktor) duhet të paguajë pjesën e mbetur të demit.

Neni 33:

Nryshimi i Ligjeve dhe Rregulloreve

Nëse pas datës së nënshkrimit të kontratës, ndonjë ligj, rregullore, urdhëresë, urdhër ose procedurë me efektin e ligjit në Republikën e Shqipërisë hyn në fuqi, nxirret ose ndryshon dhe ndikon kushtet, duke përfshirë datën e dorëzimit, ose çmimin e kontratës, kushtet ose çmimi i kontratës do të rregullohen në atë masë sa kontraktori është ndikuar në përmbushjen e detyrimeve të tij sipas kontratës.

Neni 34:

Forca Madhore

Kontraktori nuk duhet të mbajë përgjegjësi për humbjen e sigurimit të kontratës, dëmeve të likuidueshme ose ndërprerjen për mosplotësim, nëse dhe deri në masën që vonesa në zbatim ose



ndonjë dështim tjetër në përmbushjen e detyrimeve të tij sipas kontratës, vijnë si pasojë e ngjarjeve të Forcës Madhore.

Për qëllimet e këtij neni "Forcë Madhore" do të thotë një ngjarje jashtë kontrollit të kontraktorit dhe e paparashikueshme. Ngjarje të tilla mund të përfshijnë, por nuk kufizohen nga, veprimet e Autoritetit Kontraktor, qoftë në kapacitetin e tij sovran ose kontraktual, lufta ose revolucionet, zjarri, përmytja, tërmeti, epidemitë, shtrëngime të karantinës dhe embargo tranziti.

Nëse ndodh ndonjë situatë e Forcës Madhore, kontraktori duhet të njoftojë menjehere Blerësin Publik. Me përjashtim kur Autoriteti Kontraktor jep udhëzime të ndryshme, kontraktori duhet të vazhdojë të zbatojë detyrimet e tij sipas kontratës në masën praktikisht të arsyeshme dhe duhet të kërkojë të gjitha mjetet e arsyeshme për zbatimin që nuk pengohet nga Forca Madhore.

Neni 35:

Vonesa në Zbatim dhe Zgjatja e Afatit

Kontraktori duhet të fillojë zbatimin e kontratës menjëherë pas nënshkrimit të saj.

Me përjashtim kur Autoriteti Kontraktor është dakort për zgjatje të afatit të kontratës, ka të drejtë të kërkojë dëmet për vonesën në zbatim, nëse kontraktori dështon në dorëzimin e punës brenda Afatit së Dorëzimit të Plotë të specifikuar në kontratë.

Autoriteti Kontraktor mund të zbresë shumën e dëmeve të likuidueshme që duhen paguar nga shuma e pagesës ndaj kontraktorit. Në rast të tillë Autoriteti Kontraktor duhet t'i japi kontraktorit njoftim me shkrim për shumën dhe arsyen e zbritjes.

Autoriteti Kontraktor do të jetë dakort për një zgjatje të afatit, në rastin e Forcës Madhore.

Autoriteti Kontraktor, mund të jetë dakort për zgjatje të afatit edhe në rrethana të tjera në se është në interesin publik për ta bërë këtë. Në rast se kontraktori ndeshet me kushte që pengojnë zbatimin në kohë, kontraktori duhet të njoftojë menjehere Autoritetin Kontraktor me shkrim për vonesën, shkakun dhe datën e propozuar të dorëzimit ose përfundimit. Autoriteti Kontraktor duhet të vlerësojë kërkesën. Nëse Autoriteti Kontraktor është dakort me vonesën, zgjatja do të hyjë në fuqi me një amendament me shkrim të kontratës të nënshkruar nga Autoriteti Kontraktor dhe kontraktori.

Neni 36:

Dëmet e Likuidueshme për Vonesën në Mbarimin e Punimeve

Dëmet e likuidueshme për vonesën në mbarimin e Punimeve do të llogariten me tarifat e mëposhtme ditore:

- a) Për kontratat me periudhë zbatimi jo më shumë se 6 muaj, tarifa ditore do të jetë 4/1000 të vlerës koresponduese të mbetur pa u zbatuar nga cmimi total i kontratës por kjo vlerë do të llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontratës.
- b) Për kontratat me periudhë zbatimi jo më shumë se 12 muaj, tarifa ditore do të jetë 2/1000 të vlerës koresponduese të mbetur pa u zbatuar nga cmimi total i kontratës por kjo vlerë do të llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontratës.
- c) Për kontratat me periudhë zbatimi më shumë se 12 muaj, tarifa ditore do të jetë 1/1000 të vlerës koresponduese të mbetur pa u zbatuar nga cmimi total i kontratës por kjo vlerë do të llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontratës.

Neni 37:

Negociatat dhe Amendamentet

Palët nuk do të negociojnë ndryshime ose amendamente të asnjë kushti të kontratës që do të ndryshonte dukshëm kushtet që përbëjnë bazën e përzgjedhjes së kontraktorit.



Asnjë amendament ose variacion tjetër i kontratës nuk do të jetë i vlefshëm pa qënë me shkrim, me datë, i referohet shprehimisht kontratës dhe nënshkruhet nga një përfaqësues i autorizuar i kontraktorit dhe Autoriteti Kontraktor.

Çdo heqje dore nga të drejtat, pushtetet ose ndreqjet që mund të bëhen nga palët sipas kontratës duhet të bëhet me shkrim, të ketë datë dhe të firmoset nga një përfaqësues i autorizuar i palës që bën këtë dorëheqje dhe duhet të specifikojë të drejtën dhe masën në të cilën ajo lëshohet.

Neni 38:

Ndryshimi i Porosisë

Kushtet e kontratës nuk janë subjekt rinegociimi dhe amendimi pas hyrjes në fuqi me përjashtim kur lejohet specifikisht dhe parashikohet në kushtet e kontratës. Çdo amendament i kontratës duhet të bëhet me shkrim dhe firmosur nga Autoriteti Kontraktor dhe kontraktori.

Ndertime shtesë mund të porositen vetëm në rethana të përcaktuar në LPP dhe me kusht që shtesa e kontratës të mos i kalojë 20% të çmimit original të kontratës.

Autoriteti Kontraktor në çdo kohë, mund të porosisë kontraktorin të bëjë ndryshime brenda qëllimit të përgjithshëm të kontratës në secilin nga elementët e më poshtëm:

- a) Korrigjime në projektin, vizatimin ose specifikimet e Punëve
- b) Korrigjime në materiale
- c) Korrigjime në sasi

Përpara se të kërkojë një ndryshim, Autoriteti Kontraktor dhe kontraktori duhet të bien dakort për çdo rritje ose ulje të çmimit të kontratës dhe/ose ndryshim në grafikun e zbatimit ose përfundimit që është shkaktuar nga ndryshimi. Porosia e ndryshuar duhet të materilizojë amendamentet e marrveshjes. Autoriteti Kontraktor nuk ka të drejtë të nxjerrë pretendime për pajtimin me ndryshimin e porositur përveç rregullimeve të siguruara në amendamentet e marreveshjes.

Ndryshimi i porosisë nuk do të jete i vlefshëm nese nuk formalizohet sipas kerkesave te Nenit mesiperm te ketyre kushteve te pergjithshme.

Neni 39:

Preventivi per Njesi ose ne Total

Kontrata do të përfshijë një Preventiv ne Total nëse është një kontratë me shumë totale ose një Preventiv per Njesi nëse është një kontratë me çmim njesie. Nëse është një kontratë me çmim njesie, Preventivi per Njesi do të përmbajë volumet e zerave te ndërtimit, instalimin, testimin dhe komisionet që bëhen nga kontraktori.

Preventivi per Njesi do të përdoret për të llogaritur çmimin e kontratës. Kontraktori do të paguhet për sasinë e realizuar me tarifën në Preventivin ne Njesi për secilin ze punimesh.

Neni 40:

Mbarimi dhe Marrja Përsipër e Ndertimeve

Kontraktori duhet t'i kërkojë drejtuesit të projektit t'i lëshojë një certifikatë për mbarimin e Punimeve dhe drejtuesi i projektit do t'a bëjë këtë sapo të vendosi se Punimet janë mbaruar plotësisht.

Nëse drejtuesi i projektit zbulon se Punimet nuk janë përfunduar plotësisht, drejtuesi i projektit do t'i japi udhëzime me shkrim kontraktorit që specifikojnë zerat e punimeve ose aktivitetet që duhen përfunduar para se të lëshohet certifikata.

Nëse drejtuesi i projektit zbulon defekte në Punime, drejtuesi i projektit duhet t'i japi kontraktorit njoftim me shkrim duke specifikuar defektet që duhet të korrigjohen para se të lëshohet certifikata.

Neni 41:

Ndërprerja për Shkak të Interesit Publik



Neni 47:
Përfaqesimi i Palëve

Çdo palë duhet të emërojë me shkrim një person ose strukturë organizative, që do të jetë përgjegjës, në emër të palës, për marrjen e komunikatave dhe për përfaqësimin e palës në çështjet e lidhura me egzekutimin e kontratës.

Secila palë duhet të lajmërojë palën tjetër menjëherë për ndonjë ndryshim në emërimin e përfaqësuesit të palës. Nëse njëra palë dështon të lajmërojë, duhet të marrë përsipër çdo humbje të shkaktuar nga dështimi për të dhënë njoftim të mjaftueshëm.

Palët mund të emërojnë persona ose struktura organizative shtesë për të përfaqësuar palën në veprime ose veprimtari të veçanta në të cilin rast njoftimi me shkrim duhet dhënë dhe duhet të përcaktojë shtrirjen e autoritetit të përfaqësuesit.

Neni 48:
Lajmërimet

Çdo lajmërim i dhënë nga njëra palë tjetër sipas kontratës duhet të bëhet me shkrim në adresën e specifikuar në kontratë.

Njoftimi do të ketë efekt sapo të dorëzohet.

Neni 49:
Llogaritja e Afateve

Të gjitha referencat e ditëve do të jenë ditë kalendarike me përjashtim kur parashikohet ndryshe.

Neni 50:
Dizpozita Perfundimtare

Kontraktori, 5 dite para fillimit të punimeve duhet të njoftoj me shkrim KESH, ALBTELEKOM, UJESJELLES KANALIZIM SH.A, që të jenë prezente me specialistet e tyre në fillimin e punimeve apo gjatë zbatimit të punimeve kur punimet kanë të bëjnë me procese teknike specifike apo me levizjen e materialeve ose objekteve të cilat janë ekskluzivitet i subjekteve të mesipërme.

Kësaj kontrate i bashkëngjiten: Specifikimet teknike, preventiv fitues i tenderit, projekti dhe Dokumentat Standarte të Tenderit.

Kjo kontratë është përpiluar në 5 (pese) kopje origjinale në gjuhën shqipe me vlerë të njëjtte juridike dhe hyn në fuqi me nënshkrimin e saj nga palët.

Pasi u lexua dhe u gjet e rregullt, me vullnetin e lire dhe të plote, kjo kontratë u nënshkrua nga:

Per dhe ne emer te Autoriteti Kontraktor:

BASHKIA ROSKOVEC

Perfaqesuar nga Kryetari:



Per dhe ne emer te Kontraktorit:

"Pese Vellezerit" Sh.p.k. & "Boshnjaku B" Sh.p.k

Perfaqesuar nga:

Handwritten signatures of the contractor representatives.



Shtojca 18

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]
KUSHTET E VEÇANTA

Punët – Procedura e Hapur

Kushtet e veçanta të Kontratës do të plotësojnë Kushtet e Përgjithshme të Kontratës. Në rast se ka mospërputhje midis KPK dhe KVK do të mbizotërojnë Kushtet e veçanta të kontratës.

Neni 1: Përkufizime

1.1 Autoriteti Kontraktor është: **BASHKIA ROSKOVEC**

1.2 Kontraktori është B.O.: **“Pese Vellezerit” Sh.p.k.& “Boshnjaku B” Sh.p.k**

1.3 Neni 2:

Sigurimi i Kontrates

2.1 Sigurimi i kontratës në shumën prej (10% të vlerës së ofertës) duhet të ofrohet nga kontraktori për të siguruar ekzekutimin e detyrimeve të tij sipas kontratës.

2.2 Sigurimi i kontratës do t'i lëshohet ose kthehet, menjëherë, kontraktorit sipas skedarit të mëposhtëm: Jo me vonë se 30 (tridhjetë) dite nga marrja në dorezim e punimeve, ku 5% e sigurise se kontrates do te mbahet deri perfundimin e periudhes 1 (nje) vjecare te garancise se punimeve.

Neni 3: Drejtuesi i Projektit

3.1 Drejtuesi i Projektit do të jetë: _____

3.2 Adresa/pika e kontaktit: _____

Neni 4: Kantieri

4.1 Kantieri i Punëve do të jetë (Pershkrimi i saktë i venddodhjes së objektit që do të realizohet):

“Rikonstruksioni i rruges Kuman - Luar - Vidhishte, Pr 1900- 4110, L= 2210ml, b=4+2x0.5m”

Neni 5: Data e Fillimit

5.1 Kontraktorit do t'i jepet leja për të hyrë në kantier më: _____. _____. 2018

Neni 6: Siguracioni

6.1 Nga Data e hyrjes deri në Afatin e Mbarimit kontraktori duhet të ketë siguracion që mbulon deri në shumën prej:

- Për dëmtime ose humbje të Punëve dhe Materialeve
- Për dëmtime ose humbje të Pajisjeve
- Për dëmtime ose humbje të pasurisë përveç Punëve, Materialeve dhe Pajisjeve
- Për dëmtim personal ose vdekje të personave në kantier

Neni 7: Inspektimet dhe Testimet

7.1 Inspektimet dhe testimet para vërtetimit të mbarimit të Punëve do të përfshijnë: **Kontrollin periodik të punimeve të kryera nga Kontraktori.**

7.2 Kjo kontratë do të çmohet si një

- Kontratë me Çmim Njësie të bazuar në çmimet e njësisë të shprehura në Preventivin në Njësi
- Kontratë me Shumë Totale

Neni 9: Grafiku i Pagesës



- 9.1 Pagesa duhet bërë sipas grafikut të mëposhtëm: **Situacioni mujor (perfundimtar) te paraqitur nga Kontraktori.** Pagesa për Punët duhet bërë brenda 10 (dhjete) ditëve nga data që kontraktori paraqet një dokument që deklaron se objektivi për pagesën është arritur subjekt ky i konfirmimit të dokumentit nga drejtuesi i projektit. Nëse është lënë e paplotësuar, perioda kohore do të jetë 30 ditë.
- 9.2 Monedha e pagesës do të jetë LEKE. Nëse nuk është specifikuar, pagesa do bëhet me monedhën Shqiptare.

Neni 10. Pagesa Paraprake

- 10.1 Përqindja e pagesës paraprake do të jetë : s'ka pagesa paraprake. Nëse nuk është specifikuar, kontraktori nuk do të marrë pagesë paraprake.
- 10.2 Nëse është premtuar një pagesë paraprake, avanca do të paguhet brenda __ditëve nga marrja e sigurimit te kontrates.
- 10.3 Nëse jepet pagesa paraprake, shuma do të hiqet nga pagesa që duhet t'i jepet kontraktorit sipas formulës së mëposhtme: _____

Neni 11. Shërbimet në Lidhje me to

- 11.1 Kushtet e veçanta të mëposhme do të zbatohen për kryerjen e pagesës së shërbimeve të lidhura

Neni 12. Zbritja e garancisë së kontratës

- 12.1 Nëse parashikohet zbritje periodike të garancisë së kontratës ajo kryhet si më poshtë

Nëse nuk plotësohet, garancia mbetet e pandryshuar.

Autoriteti Kontraktor

Kontraktuesi

BASHKIA ROSKOVEC

Shoqeria **"Pese Vellezerit" Sh.p.k. & "Boshnjaku B" Sh.p.k**

Emri dhe firma e Përfaqësuesit

Emri dhe firma e Përfaqësuesit





Vula:

Vula:

Adresa:

Adresa:

Tel:

Tel:





REPUBLIKA E SHQIPERISE
AUTORITETI KONTRAKTOR
BASHKIA ROSKOVEC

No. 1133 Prot.

Datë 11.03.2019

KONTRATE PUNE PUBLIKE

ME OBJEKT:

"Rikonstruktion i rruges "Shkolla - Kerranjaket", fshati Luar, b=4m +2*0.5m bankine)"

PALËT

AUTORITETI KONTRAKTOR :

BASHKIA ROSKOVEC

KONTRAKTOR:

"BOSHNJAKU-B" -shpk



Neni 1:

Palet kontraktuese

BASHKIA ROSKOVEC, e perfaqesuar nga Kryetari znj.Majlinda BUFI, ne vijim i quajtur Autoriteti Kontraktor.

Dhe

Shoqeria: "E OSHNJAKU-B" -shpk perfaqesuar nga **Bashkim Dulla** Administratori i shoqerise ne vijim i quajtur Kontraktori.

Neni 2:

Objekti i kontrates

Kjo kontrate lidhet per realizimin e punimeve me objekt „Rikonstrukcion i rruges "Shkolla - Ferraniak et", fshat Luar, b=4m +2*0.5m bankine).“ ne BASHKIA ROSKOVEC.

Neni 3:

Vlera e kontrates

Vlera totale e objektit eshte 6 074 926 (gjashtemilion e shtatedhjete e katermije e nenteqind e njetete e qishite) leke pa tvsh 7 289 911 (shtatemilion e dyqind e tetedhjete e nentemije e nenteqind e nje mbedhjete) leke me tvsh e fituar nga Kontraktori ne tenderin e organizuar nga Autoriteti Kontraktor BASHKIA ROSKOVEC.

Neni 4:

Përkufizime

- "Preventiv total" do të thotë volumet e punes te dhena ne projekt te cilat jane orientuese, plotësuar me cmimin total të përcaktuar që është pjesë e Ofertes në një kontratë me çelsa ne dore.
- "Preventiv per njesi" do të thotë volumet e punes te dhena ne projekt shoqeruar me cmimet per njesi te pandryshues qe janë pjesë e Ofertes në një kontratë me punime ne matje.
- "Afati i realizimit te punimeve" do të thotë data që Punët duhet të përfundojnë siç është shprehur në Grafikon për realizimin Punimeve , e vertetuar nga enti prokurues.
- "Kontratë" do të thotë marrëveshja e shkruar e lidhur midis Autoritetit Kontraktor dhe kontraktorit që përbëhet nga dokumentat e tenderit duke përfshirë KPK dhe KVK, të gjitha bashkangjitet dhe formularët e plotësuar dhe të gjitha dokumentat e tjera që përfshihen në referimin e çdo dokumenti.
- "Cmim kontrate" do të thotë cmimi që i paguhet kontraktorit sipas kontratës për zbatimin e plotë dhe të përpiktë të detyrimeve të tij kontratore.
- "Realizimi i punimeve" do të thotë data e vërtetuar nga Autoriteti Kontraktor se Punët janë mbaruar.
- "Defekte" do të thotë çdo pjesë e Punimeve e paperfunduar në përputhje me kontratën.
- "Data e hyrjes" do të thotë data që Autoriteti Kontraktor lejon kontraktorin në kantier.
- "Data e fillimit" eshte perfshire ne Të dhënat e kontrates. Ajo eshte data kur Sipërmarresi do të fillojë punimet e ndërtimit.
- "Pajisje" do të thotë makineritë dhe veglat e kontraktorit të sjella përkohësisht në kantier për realizimin e Ndërtimeve.
- "Materiale" do të thotë të gjitha furnizimet, duke përfshirë ato të konsumit, të përdorura nga kontraktori për punimet e punimeve.
- "Objekti i kontrates" do të thotë të gjitha Punët që kontraktori do të sigurojë sipas kushteve të kontratës.



- "Palë(t)" do të thotë nënshkruarit e kontratës.
- "Drejues projekti" do të thotë personi i emëruar nga Autoriteti Kontraktor që është përgjegjës për administrimin e kontratës për Autoritetin Kontraktor.
- "Autoritet Kontraktor" do të thotë Autoriteti Kontraktor që është pjesë e kësaj kontrate dhe që kontraktori punët objekt i kësaj kontrate. Ky term kudo që përdoret ka kuptim të njëjtë me atë të përkufizuar në ligj.
- "Kantieri" do të thotë vendi fizik i Punimeve.
- "Raport i Inspektimit të Kantierit" do të thotë dokumentat e përfshira në dokumentat e tenderit që pasqyrojnë informacion faktik dhe të interpretuar rreth kushteve të sipërfaqes dhe nëntokës së Kantierit.
- "Nënkontraktues" do të thotë çdo person fizik ose ligjor ose kombinim i mësipërm, që furnizon Punët, materialet ose pajisjet për ose në emër të kontraktorit.
- "Kontraktori" do të thotë personi fizik ose juridik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate siguron Punimet.
- "Standarte Teknike" do të thotë specifikimet e aprovuara nga një trup i posaçëm standartizimi për zbatimin e vazhdueshëm ose të përsëritur. Standarte të tilla përdoren si rregulla, rregullore ose përkufizim të karakteristikave për të siguruar se materialet dhe shërbimet e procesuara i përgjigjen qëllimit.
- "Ngjitja e kantierit" do të thotë punimet e ndertimit të përkohshme, të ndërtuara e instaluara, që janë të nevojshme për zbatimin e punimeve të ndërtimit.
- "Punime" do të thotë ajo që Autoriteti Kontraktor i kërkon nga kontraktori të gërmojë, ndërtojë, riparojë, rinovojë ose instalojë siç parashikohet në dokumentat e tenderit duke përfshirë shërbimet në lidhje me to, gjithashtu të përkufizuara në dokumentat e tenderit.

Neni 5 :

Data e nënshkrimit të kontratës, fillimit të punimeve dhe afati për perfundimin e punimeve
 Si më datë _____, 2019 nënshkruhet kjo kontratë sipërmarrje ndërmjet Autoritetit Kontraktor dhe Kontraktorit. Data e fillimit të punimeve menjëherë pas lidhjes së kontratës së mbikqyresit të punimeve. Afati për perfundimin e punimeve është 3 (tre) muaj nga data e fillimit të punimeve.

Neni 6:

Garancia e punimeve

Garancia e punimeve është 1 (një) vit. Periudha e garancisë së punimeve fillon nga data e kolaudimit të punimeve dhe përfundon brenda 1 (një) viti. Në përfundim të periudhës së garancisë së punimeve: Autoriteti Kontraktor, Kontraktori, Mbikqyresit të Punimeve dhe Kolaudatori bëjnë kontrollin përfundimtar të punimeve dhe nëse nuk ka defekte të punimeve, lëshojnë Certifikatën Përfundimtare të Marëzimit të Punimeve.


Neni 7

Perfaqesuesit e Invesitorit

Nga ana e Autoritetit Kontraktor do të vendosen si perfaqesues pranë Kontraktorit persona të autorizuar prej Kryetarit të Autoritetit Kontraktor të cilët do të jenë me cilësi të mëposhtme:

Drejues i Punimeve _____ me Licence _____.

Mbikqyresit të Punimeve _____ me Licence _____



Neni 8:

Hartimi i Kontratës

Njoftimi i ofertes fituese shërbeu për hartimin e kontratës midis palëve. Ekzistenca e kontratës do të konfirmohet me nënshkrimin e dokumentit të kontratës duke sanksionuar të gjitha marrëveshjet midis palëve.

Neni 9:

Praktikat e Korruptuara, Konflikti i Interesit dhe Kontrolli i Procesverbaleve

Autoriteti Kontraktor mund t'i kërkojë gjykatës të deklarojë të paligjshme kontratën nëse zbulon se Kontraktori ka kryer veprime të korruptuara. Veprimet e korruptuara përfshijnë veprimet e përshkruara në dispozitat e Ligjit mbi Prokurimin Publik.

Neni 10:

Informacioni Konfidencial

Autoriteti Kontraktor dhe Kontraktori duhet të mbajnë në konfidencë të gjitha dokumentat, të dhënat dhe informacionet e tjera të dhëna nga pala tjetër në lidhje me kontratën. Kontraktori mund t'i japë nënkontraktorit dokumenta të tilla, të dhëna ose informacione të tjera që mërr nga Autoriteti Kontraktor deri në masën e kërkuar që nënkontraktorin të zbatojë punën e tij sipas kontratës.

Neni 11:

Prona Intelektuale

Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, të gjitha të drejtat e pronës intelektuale të siguruara nga kontraktori gjatë zbatimit të kontratës do t'i përkasin Autoritetit Kontraktor i cili mund t'i përdorë ato sipas gjykimit të tij.

Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, kontraktori, pas përfundimit të kontratës, duhet t'i dorëzojë Autoritetit Kontraktor të gjitha raportet dhe të dhënat si hartat, diagramat, skicimet, specifikimet, planet, statistikën, llogaritjet dhe regjistrat mbështetës ose materialet e fituara, mbledhura ose përgatitura nga kontraktori gjatë zbatimit të kontratës. Kontraktori mund të mbajë kopje të këtyre dokumentave dhe të dhënave, po nuk duhet t'i përdori për qëllime që s'kanë lidhje me kontratën pa leje paraprake me shkrim nga Autoriteti Kontraktor.

Kontraktori duhet të garantojë Autoritetin Kontraktor zhveshjen nga përgjegjësia për shkelje të të drejtave të pronës intelektuale, që mund të dalin nga përdorimi i materialeve, skicave ose çdo prone tjetër sipas kontratës.

Në rast se ngrihet ndonjë pretendim ose padi kundër Autoritetit Kontraktor në lidhje me ndonjë shkelje të pronës intelektuale të shkaktuar nga zbatimi i kontratës ose nga përdorimi i materialeve, skicave ose çdo prone tjetër të mbrojtur e të furnizuar sipas kontratës, kontraktori duhet t'i japë Autoritetit Kontraktor të gjitha provat dhe informacionin në posedim të kontraktorit që kanë të bëjnë me këtë padi apo pretendim.



Neni 12:

Origjina e Materialeve

Nuk ka asnjë kufizim për kombësinë e origjinës së materialeve, përveç atyre që mund të jenë përvaktuar në ndonjë Rezolutë të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara.

Neni 13:

Vendimet e Drejtuesit të Projektit

Drejuesi i projektit do të vendosë për çështjet e kontratës midis kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor.

Drejuesi i Projektit mund të delegojë ndonjë nga detyrat dhe përgjegjësitë e tij tek të tjerët përveç zgjidhjen e mosmarrveshjeve dhe konflikteve. Drejtuesi i projektit duhet të njoftojë kontraktorin për delegimet e bëra apo të revokuara.

Neni 14:

Komunikimi

Çdo komunikim midis palëve duhet të bëhet me shkrim.

Neni 15:

Përgjegjësia e Autoritetit Kontraktor

Autoriteti Kontraktor ka përgjegjësi të kompensojë kontraktorin për dëmtime të pajisjeve të kontraktorit deri në masën që lidhet me veprime me faj të Autoritetit Kontraktor ose të projekteve të Autoritetit Kontraktor.

Neni 16:

Kontraktori që Kryen Punimet

Kontraktori duhet të kryejë dhe mbarojë Punimet në përputhje me specifikimet teknike të paraqitura në dokumentat e tenderit.

Kontraktori nuk mban përgjegjësi për gabimet në projekt, të dhëna, planimetri ose aspekte të tjera të specifikimeve teknike, të dhëna nga Autoriteti Kontraktor.

Kodeksi dhe standartet që do zbatohen do të jenë të shprehura në dokumentat e tenderit. Nëse gjatë ekzekutimit të kontratës, ka ndryshime në zbatimin e kodeve ose standarteve, këto ndryshime do të zbatohen vetëm pasi të jenë aprovuar nga Autoriteti Kontraktor.

Neni 17:

Ekzekutimi i Punimeve

Kontraktori duhet të fillojë zbatimin e kontratës menjëher pas nënshkrimit të saj dhe duhet t'i mbarojë Punimet brenda Afatit të Mbarimit 3 (tre) muaj nga data e fillimit të punimeve.

Neni 18:

Ngritja e Kantierit

Kontraktori mban përgjegjësi për projektin e Ngritjes së Kantierit.

Kontraktori duhet të paraqesë të gjitha planet për Ngritjen e Kantierit tek drejtuesi i projektit për shqyrtimin dhe miratimin e tij.



Neni 19:

Sigurimi Teknik dhe Mjedisor

Kontraktori do të mbajë përgjegjësi për sigurinë e të gjitha aktiviteteve në kantier.
Kontraktori do të sigurojë kantierin në mënyrë të tillë që të minimizojë dëmtimet e mjedisit. Ai duhet të kursojë energjinë, ujin dhe burime të tjera, të reduktojë humbjen dhe të minimizojë përdorimin e substancave varfëruese të ozonit, qirimitin e gazrave, Lëndët e përbëra organike të rezikshme dhe substancave të tjera, që dëmtojnë shëndetin dhe mjedisin.

Neni 20:

Zbulimet

Çdo gjë me interes historik ose me vlerë të konsiderueshme e zbuluar papritur në kantier do të deklarohet për të vepruar konform legjislacionit në fuqi. Kontraktori duhet të njoftojë drejtuesin e projektit për ndonjë zbulim të tillë dhe të ndjekë udhëzimet e drejtuesit të projektit për procedurën e administrimit të objekteve.

Neni 21:

Disponimi i Kantierit

Autoriteti Kontraktor duhet t'i japë drejtën e disponimit të kantierit kontraktorit në datën e hyrjes të shprehur në dokumentat e tenderit. Nëse disponimi i ndonjë pjese të kantierit nuk jepet brenda datës së hyrjes për kantierin ose asaj pjese të kantierit siç parashikohet në dokumentat e tenderit, do të konsiderohet se Autoriteti Kontraktor ka vonuar fillimin e zbatimit të kontratës, dhe kontraktori i linc e drejta të kërkojë amendimin e kontratës në lidhje me shtyrjen e Afatit të Mbarimit. Autoriteti Kontraktor dhe kontraktori do të mbajnë procesverbal për datën e hyrjes.

Neni 22:

Raportimi i Grafikut të Zbatimit

Mënjëherë pas lidhjes së kontratës, kontraktori duhet t'i paraqesë drejtuesit të projektit një program plani që tregon metodat e përgjithshme, rregullimet, porosinë, afatet dhe rrugët kritike për aktivitetet e Punimeve.

Në intervale të skeduar rregullisht siç është aprovuar nga drejtuesi i projektit, kontraktori duhet të përgatisë raporte duke treguar progresin e arritur në çdo aktivitet dhe efektet e progresit në punën e mbetur, duke përfshirë çdo ndryshim në sekuencën e aktiviteteve.

Neni 23:


Paralajmërimi në Kohë

Kontraktori duhet të paralajmërojë drejtuesin e projektit sa më shpejt të jetë e mundur për ngjarje dhe rrethanat specifike që mund të ndodhin në të ardhmen apo që mund të ndikojnë negativisht në zbatimin e kontratës, duke përfshirë cilësinë e punës dhe vonesën në afate.

Neni 24:

Kontrolli i Cilësisë

Kontraktori do të jetë plotësisht përgjegjës për kontrollin e cilësisë dhe zbatimin e kontratës. Drejtuesi i projektit duhet të kontrollojë punën e kontraktorit dhe të njoftojë kontraktorin për defekte që mund të jenë gjetur. Sa herë që shfaqen defekte, kontraktori duhet të korrigjojë defektin brenda afatit të parashikuar në kontratë.



Neni 25:

Defektet e Pakorrigjuara

Nëse kontraktori nuk e ka korrigjuar një defekt brenda kohës së specifikuar në njoftimin për defektin nga drejtuesi i projektit, drejtuesi i projektit do të llogarisë koston e korrigjimit të defektit dhe kjo shumë do të mbahet nga çdo pagasë që i duhet bërë kontraktorit deri sa defekti të korrigjohet. Dëshimi për të korrigjuar defektin brenda një afati të arsyeshëm përbën shkak për zgjidhje kontrate për arsye mospërbushje në favor të Autoriteti Kontraktor.

Neni 26:

Përgjegjësitë e Autoriteti Kontraktor

Nga Afati i fillimit deri në Afatin e Realizimit të Plote, Autoriteti Kontraktor do të jetë përgjegjës për:

- (a) dëmtim personal, vdekje ose humbje apo dëmtim të pasurisë për shkak të neglizhencës ose ndërhyrjes, qoftë edhe të ligjshme nga Autoriteti Kontraktor apo nga çdo person i punësuar/kontraktuar nga Autoriteti Kontraktor, përveç kontraktorit.
- (b) dëmtim të Punimeve, materialeve dhe pajisjeve deri në atë masë që lidhet me fajin e Autoritetit Kontraktor apo me projektin e tij.

Neni 27:

Përgjegjësitë e kontraktorit

Nga Afati i fillimit deri në Afatin e Realizimit, kontraktori do të jetë përgjegjës për dëmtim personal, vdekje ose humbje apo dëmtim të pasurisë, dhe pasuri të tjera dhe që nuk mbulohen nga Autoriteti Kontraktor sipas Nenit 1 mesipër.

Neni 28:

Testimet dhe Inspektimet

Kontraktori duhet të bëjë të gjitha testet dhe inspektimet e kërkuara nga dispozitat e kontratës. Kosto e këtyre testeve dhe inspektimeve duhet të financohet tërësisht nga kontraktori brenda çmimit të kontratës.

Autoriteti Kontraktor me shpenzimet e tij, ka të drejtë të ndjekë testimet dhe/ose inspektimet. Nëse materialet prodhohen ose përgatiten në vende të ndryshme nga ato të kontraktorit, kontraktori duhet të sigurojë leje për Autoritetin Kontraktor për të ndjekur këto testime dhe inspektime.

Autoriteti Kontraktor gjithashtu mund t'i kërkojë kontraktorit të bëjë testime ose inspektime shtesë të paparrshikuesara në kontratë por të gjykuara të nevojshme për të verifikuar se Punimet janë konform specifikimeve dhe kushteve të kontratës. Autoriteti Kontraktor do të mbajë përgjegjësi për koston e këtyre testeve. Gjithashtu, nëse këto teste ndalojnë progresin e punës së kontraktorit, Autoriteti Kontraktor do të bjerë dakor të ndryshojë grafikun.


Autoriteti Kontraktor do të refuzojë çdo Punim që nuk e kalon testimin dhe/ose inspektimin ose nuk është konform specifikimeve teknike dhe kushteve të kërkuara në zbatimin e kontratës.

As ekzekutimi i testeve as inspektimi i Punimeve nuk do ta lirojë kontraktorin nga çdo garanci ose detyrim tjetër sipas kontratës.

Neni 29:

Garancitë

Kontraktori garanton se materialet e trupëzuara me Punët janë të reja, të papërdorura dhe të modeleve të fundit (dh: se trupat e punësuesve dhe inzhinierëve të punësuesve të fundit në projekt dhe materiale, me përjashtim kur parashikohet ndryshe në kontratë).



Me përjashtim të ndonjë parashikimi në kontratë ose nga ligji, kontraktori garanton se materialet nuk kanë defekte të shkaktuara nga ndonjë veprim ose mosveprim i kontraktorit apo të shkaktuara nga projektimi i materialet dhe puna nën kushte normale përdorimi, për kushtet që mbizotërojnë në Shqipëri.

Neni 30:

Çmimi i Kontratës

Çmimet e kontraktorit për Punët e kryera sipas kontratës nuk duhet të ndryshojnë nga çmimet e ofruar nga kontraktori në ofertën e tij.

Neni 31:

Kushtet e Pagesës

Çmimi i Kontratës, duke përfshirë edhe pagesat paraprake, duhet të paguhet siç specifikohet në kontratë.

Pagosa do të bëhet me monedhë Shqiptare.

Burimi i Financimit: Te ardhurat e vota

Financimi për vitin 2019: 416 667 leke pa tvsh

Financimi për vitin 2020: 5 658 259 leke pa tvsh

Kontraktori ka të drejtë të marrë pagosa periodike gjatë progresit të zbatimit të projektit. Grafiku i pagesave periodike do të jetë çdo muaj. Çdo fillim muaji Kontraktori paraqet për likuidim situacionin e punimeve për muajin paraardhës.

Drejtuasi i projektit duhet të kontrollojë Punimet e ekzekutuara nga kontraktori dhe duhet të verifikojë shumën që duhet të paguhet kontraktorit, brenda 10 ditëve pune nga data që kontraktori paraqet komunikatën e tij tek drejtuesi i projektit.

Pagosa e periodike për Punët do të bëhet brenda 10 ditëve kalendarike nga data që progresi i grafikut të zbatimit është verifikuar nga drejtuesi i projektit.

Data e pagasës do të jetë dita që fondi xhirohet nga llogaria e Autoritetit Kontraktor.

Neni 32:

Vonesa në Bërjen e Pagesës

Kontraktori ka të drejtë të shtyj afatit e përfundimit të punimeve në rast se Autoriteti Kontraktor nuk paguan detyrimet financiare sipas situacionit të miratuar nga Mbikqyesi I Punimeve.

Shpërblim për demin të shkaktuar si rezultat i vonesës në pagesë konsiston në kamaten e arritur nga data e fillimit të vonesës së debitorit (Autoriteti Kontraktor), në monedhën zyrtare të vendit ku do të bëhet pagesa. Përqindja e kamates parashikohet me ligj. Në fund të çdo viti kamatat e arrira i shihen shumës totale, mbi të cilën është bërë llogaritja e tyre.

Kamata ligjore paguhet pa qene i detyruar kreditori (kontraktori) të provojë ndonjë dem. Nëse kreditori (Kontraktori) provon se ka pesuar një dem me të madh se kamata ligjore, debitori (Autoriteti Kontraktor) duhet të paguajë pjesën e mbetur të demit.

Neni 33:

Nryshimi i Ligjeve dhe Rregulloreve

Nëse pas datës së nënshkrimit të kontratës, ndonjë ligj, rregullorë, urdhëresë, urdhër ose procedurë me efektin e ligjit në Republikën e Shqipërisë hyn në fuqi, nxirret ose ndryshon dhe ndikon kushtet, duke përfshirë datën e dorëzimit, ose çmimin e kontratës, kushtet ose çmimi i kontratës do të rregullohen në atë masë sa kontraktori është ndikuar në përbushjen e detyrimeve të tij sipas kontratës.



Neni 34:

Forca Madhore

Kontraktori nuk duhet të mbajë përgjegjësi për humbjen e sigurimit të kontratës, dëmeve të likuidueshme ose ndërprerjen për mosplotësim, nëse dhe deri në masën që vonesa në zbatim ose ndonjë dështim tjetër në përmbushjen e detyrimeve të tij sipas kontratës, vijnë si pasojë e ngjarjeve të Forcës Madhore.

Për qëllimet e këtij neni "Forcë Madhore" do të thotë një ngjarje jashtë kontrollit të kontraktorit dhe e paparashikueshme. Ngjarje të tilla mund të përfshijnë, por nuk kufizohen nga, veprimet e Autoritetit Kontraktor, t'i ofrë në kapacitetin e tij sovran ose kontraktual, lufta ose revolucionet, zjarri, përmbytja, tërmeti, epidemitë, shtrëngime të karantinës dhe embargo tranziti.

Nëse ndodh ndonjë situatë e Forcës Madhore, kontraktori duhet të njoftojë menjehere Blerësin Publik. Me përjashtim kur Autoriteti Kontraktor jep udhëzime të ndryshme, kontraktori duhet të vazhdojë të zbatojë detyrimet e tij sipas kontratës në masën praktikisht të arsyeshme dhe duhet të kërktojë të gjitha mjetet e arsyeshme për zbatimin që nuk pengohet nga Forca Madhore.

Neni 35:

Vonesa në Zbatim dhe Zgjatja e Afatit

Kontraktori duhet të fillojë zbatimin e kontratës menjëherë pas nënshkrimit të saj.

Me përjashtim kur Autoriteti Kontraktor është dakort për zgjatje të afatit të kontratës, ka të drejtë të kërktojë dëmet për vonesën në zbatim, nëse kontraktori dështon në dorëzimin e punës brenda Afatit së Dorëzimit të Plotë të specifikuar në kontratë.

Autoriteti Kontraktor mund të zbrersë shumën e dëmeve të likuidueshme që duhen paguar nga shuma e pagesës ndaj kontraktorit. Në rast të tillë Autoriteti Kontraktor duhet t'i japi kontraktorit njoftim me shkrim për shumën dhe arsyen e zbritjes.

Autoriteti Kontraktor do të jetë dakort për një zgjatje të afatit, në rastin e Forcës Madhore.

Autoriteti Kontraktor, mund të jetë dakort për zgjatje të afatit edhe në rrethana të tjera në se është në interesin publik për ta bërë këtë. Në rast se kontraktori ndeshet me kushte që pengojnë zbatimin në kohë, kontraktori duhet të njoftojë menjehere Autoritetin Kontraktor me shkrim për vonesën, shkakun dhe datën e propozuar të dorëzimit ose përfundimit. Autoriteti Kontraktor duhet të vlerësojë kërkesën. Nëse Autoriteti Kontraktor është dakort me vonesën, zgjatja do të hyjë në fuqi me një amendament me shkrim të kontratës të nënshkruar nga Autoriteti Kontraktor dhe kontraktori.

Neni 36:

Dëmet e Likuidueshme për Vonësën në Mbarimin e Punimeve

Dëmet e likuidueshme për vonësën në mbarimin e Punimeve do të llogariten me tarifën e mëposhtme:

- Për kontratat me periudhë zbatimi jo më shumë se 6 muaj, tarifa ditore do të jetë 4/1000 të vlerës koresponduese të mbetur pa u zbatuar nga cmimi total i kontratës por kjo vlerë do të llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontratës.
- Për kontratat me periudhë zbatimi jo më shumë se 12 muaj, tarifa ditore do të jetë 2/1000 të vlerës koresponduese të mbetur pa u zbatuar nga cmimi total i kontratës por kjo vlerë do të llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontratës.
- Për kontratat me periudhë zbatimi më shumë se 12 muaj, tarifa ditore do të jetë 1/1000 të vlerës koresponduese të mbetur pa u zbatuar nga cmimi total i kontratës por kjo vlerë do të llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontratës.

Neni 37:

Negotiat dhe Amendamentet



Palët nuk do të negociojnë ndryshime ose amendamente të asnjë kushti të kontratës që do të ndryshonte dukshëm kushtet që përbëjnë bazën e përzgjedhjes së kontraktorit.

Asnjë amendament ose variacion tjetër i kontratës nuk do të jetë i vlefshëm pa qënë me shkrim, me datë, i refero rret shprehimisht kontratës dhe nënshkruhet nga një përfaqësues i autorizuar i kontraktorit dhe Autoriteti i Kontraktor.

Çdo heqje dore nga të drejtat, pushtetet ose ndreqjet që mund të bëhen nga palët sipas kontratës duhet të bëhet me shkrim, të ketë datë dhe të firmoset nga një përfaqësues i autorizuar i palës që bën këtë dorëheqje dhe duhet të specifikojë të drejtën dhe masën në të cilën ajo lëshohet.

Neni 38:

Ndryshimi i Porosisë

Kushtet e kontratës nuk janë subjekta rinegociimi dhe amendimi pas hyrjes në fuqi me përjashtim kur lejohet specifikisht dhe parashikohet në kushtet e kontratës. Çdo amendament i kontratës duhet të bëhet me shkrim dhe firmosur nga Autoriteti Kontraktor dhe kontraktori.

Ndërtimet shtesë mund të porositen vetëm në rethana të përcaktuara në LPP dhe me kusht që shtesa e kontratës të mos kalojë 20% të çmimit origjinal të kontratës.

Autoriteti Kontraktor në çdo kohë, mund të porosisë kontraktorin të bëjë ndryshime brenda qëllimit të përgjithshëm të kontratës në secilin nga elementët e më poshtëm:

- a) Korrigjime në projektin, vizatimin ose specifikimet e Punëve
- b) Korrigjime në materiale
- c) Korrigjime në sasi

Përpara se të kërkohet një ndryshim, Autoriteti Kontraktor dhe kontraktori duhet të bien dakort për çdo mënyrë ose ulje të çmimit të kontratës dhe/ose ndryshim në grafikun e zbatimit ose përfundimit që është shkaktuar nga ndryshimi. Porosia e ndryshuar duhet të materializojë amendamentet e marreveshjes. Autoriteti Kontraktor nuk ka të drejtë të nxjerrë pretendime për pajtimin me ndryshimin e porositur përveç rregullimeve të siguruara në amendamentet e marreveshjes.

Ndryshimi i porosisë nuk do të jetë i vlefshëm nëse nuk formalizohet sipas kërkesave të Nenit masipërm të katër kushteve të përgjithshme.

Neni 39:

Preventivi për Njesi ose në Total

Kontrata do të përfaqësojë një Preventiv në Total nëse është një kontratë me shumë totale ose një Preventiv për Njesi nëse është një kontratë me çmim njesie. Nëse është një kontratë me çmim njesie, Preventivi për Njesi do të përmbajë volumet e zerave të ndërtimit, instalimin, testimin dhe komisionet që bëhen nga kontraktori.

Preventivi për Njesi do të përdoret për të llogaritur çmimin e kontratës. Kontraktori do të paguhet për sasinë e realizuar me tarifën në Preventivin në Njesi për secilin ze punimesh.

Neni 40:

Mbarimi dhe Marrja Përsipër e Ndertimeve

Kontraktori duhet t'i kërkojë drejtuesit të projektit t'i lëshojë një certifikatë për mbarimin e Punimeve dhe drejtuesi i projektit do t'a bëjë këtë sapo të vendosi se Punimet janë mbaruar plotësisht.

Nëse drejtuesi i projektit zbaton se Punimet nuk janë përfunduar plotësisht, drejtuesi i projektit do t'i japë udhëzime të rreshtuara kontraktorit që specifikojnë zerat e punimeve ose aktivitetet që duhen përfunduar para të rreshtuara certifikata.



Nëse drejtuesi i projektit zbulon defekte në Punime, drejtuesi i projektit duhet t'i japi kontraktorit njoftim me shkrim duke specifikuar defektet që duhet të korrigjohen para se të lëshohet certifikata.

Neni 41:

Ndërprerja për Shkak të Interesit Publik

Autoriteti Kontraktor mund të ndërpresë kontratën në çdo kohë nëse gjykon se ky veprim duhet ndërmarrë për t'i shërbyer sa më mirë interesit publik.

Autoriteti Kontraktor duhet t'i japi kontraktorit lajmërim me shkrim për ndërprerjen.

Autoriteti Kontraktor duhet të paguajë kontraktorin për të gjitha Punët e pranuar dhe të kryera përpara ndërprerjes dhe duhet t'i paguajë kontraktorit dëmet e shkaktuara për kryerjen e pjeshme të Punëve. Në llogaritjen e shumës së dëmeve, kontraktori do të kërkohet të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për të minimizuar dëmet.

Neni 42:

Nënkontraktimi

Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është në formën e një marrveshjeje të shkruar me më të së cilës kontraktori i beson kryerjen e një pjese të detyrimeve të kontratës së tij një pale të tretë. Kontraktori nuk duhet të nënkontrakttojë pa aprovimin paraprak me shkrim të Autoritetit Kontraktor. Kontraktori duhet të njoftojë Autoritetin Kontraktor për elementet e kontratës që nënkontraktohet dhe dokumentacionin që provon aftësinë e nën-kontraktorit. Autoriteti Kontraktor duhet të lajmërojë kontraktorin për vendimin e tij, brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke shprehur arsyet nëse e aprovon apo jo atë.

Kontraktori mbetet plotësisht përgjegjës për zbatimin e kontratës pavarësisht nga sjellja e nënkontraktorit.

Neni 43:

Transferimi i të Drejtave

Kontraktori nuk duhet të transferojë, tërësisht ose pjesërisht, detyrimet e tij sipas kontratës me përjashtim kur jepen miratimi paraprak nga Autoriteti Kontraktor.

Neni 44:

Sigurimi i Kontrates

Brenda 30 ditëve nga marrja e njoftimit për fitimin e kontratës, kontraktori duhet t'i dorëzojë Autoritetit Kontraktor sigurimin e kontrates në shumën dhe formën e pranueshme siç specifikohet në kontratë. Dështimi për të dhënë sigurimin e kontrates në formën dhe në shumën e kërkuar brenda 30 ditëve do të rezultojë në anulimin e kontratës dhe humbjen e sigurimit të Ofertës të kontraktorit.

Shuma e sigurimit të kontrates duhet t'i paguhet Autoriteti Kontraktor si kompensim për çdo humbje të rezultuar nga dështimi i kontraktorit në plotësimin e detyrimeve të tij sipas kontratës.

Sigurimi i kontrates do t'i kthehet kontraktorit jo më vonë se 30 ditë pas datës së marrjes në dorëzim të punimeve. Megjithatë, pesë (5) përqind e sigurimit do të mbahet deri në përmbushjen e kënaqshme të detyrimeve të garancisë.

Neni 45:

Baza Ligjore

Kontrata dorë në dorë dhe interpretohet sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë.



Neni 46:

Zgjidhja e Mosmarrveshjeve

Autoriteti Kontraktor dhe Kontraktori duhet të bëjnë çdo përpjekje të zgjidhin mosmarrveshjet ose konfliktet e rëndësishme midis tyre ose në lidhje me këtë marrveshje me negociata direkte.

Nëse palët dështojnë në zgjidhjen e mosmarrveshjes ose konfliktit, ato i drejtohen zgjidhjes së marrveshjeve sipas kontratës dhe procedurave juridike në fuqi sipas legjislacionit të Republikës së Shqipërisë.

Neni 47:

Përfaqësimi i Palëve

Çdo palë culet të emërojë me shkrim një person ose strukturë organizative, që do të jetë përgjegjës, në emër të palës, për marrjen e komunikatave dhe për përfaqësimin e palës në çështjet e lidhura me zbatimin në kontratë.

Secila palë duhet të lajmërojë palën tjetër menjëherë për ndonjë ndryshim në emërimin e përfaqësuesit të palës. Nëse njëra palë dështon të lajmërojë, duhet të marrë përsipër çdo humbje të shkaktuar nga dështimi për të dhënë njoftim të mjaftueshëm.

Palët mund të emërojnë persona ose struktura organizative shtesë për të përfaqësuar palën në veprime ose veprimtari të veçanta në të cilin rast njoftimi me shkrim duhet dhënë dhe duhet të përcaktojë shkrijën e autoritetit të përfaqësuesit.

Neni 48:

Lajmërimet

Çdo lajmërim i dhënë nga njëra palë tjetrës sipas kontratës duhet të bëhet me shkrim në adresën e specifikuar në kontratë.

Njoftimi do të ketë efekt sapa të dorëzohet.

Neni 49:

Llogaritja e Afateve

Të gjitha rrafshet e ditëve do të jenë ditë kalendarike me përjashtim kur parashikohet ndryshe.

Neni 50:

Dizpozita Perfundimtare

Kontraktori, 5 dite para fillimit të punimeve duhet të njoftoj me shkrim KESH, ALBTELEKOM, UJESHËMBLËJ KANALIZIM SH.A, që të jenë prezente me specialistet e tyre në fillimin e punimeve apo gjatë zbatimit të punimeve kur punimet kanë të bëjnë me procese teknike specifike apo me levizjen e materialeve ose objekteve të cilat janë ekskluzivitet i subjekteve të mesiperme.

Kësaj kontrate i bashkangjiten: Specifikimet teknike, preventiv fitues i tenderit, projekti dhe Dokumentat Standarte të Tenderit.

Kjo kontratë është përpiluar në 5 (pese) kopje origjinale në gjuhën shqipe me vlerë të njejtë juridike dhe hyr në fuqi me nënshkrimin e saj nga palët.

Pasí u lexua dhe u gjet e rregullt, me vullnetin e lire dhe te plote, kjo kontrate u nënshkrua nga:

Per dhe ne emer te Autoriteti Kontraktor:

Per dhe ne emer te Kontraktorit:

BASHKIA ROSKOVJE

Perfaqesuar nga:



«BOSHNJAKU-B» -shpk

Perfaqesuar nga:



Shtojca 14

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

KUSHTET E VEÇANTA

Punët – Procedura e Hapur

Kushtet e veçanta të Kontratës do të plotësojnë Kushtet e Përgjithshme të Kontratës. Në rast se ka mosmarrëveshje midis KPK dhe KVK do të mbizotërojnë Kushtet e veçanta të kontratës.

Neni 1: Përkufizime

1.1 Autoriteti Kontraktor është: **BASHKIA ROSKOVEC**

1.2 Kontraktori është Shoqëria « **BOSHNIJAKU-B** » -shpk

1.3 Neni

2:

Sigurimi i Kontrates

2.1 Sigurimi i kontratës në shumën prej (10% të vlerës së ofertës) duhet të ofrohet nga kontraktori për të siguruar ekzekutimin e detyrimeve të tij sipas kontratës.

2.2 Sigurimi i kontratës do t'i lëshohet ose kthehet, menjëherë, kontraktorit sipas skedarit të mëposhtëm: Jo më vonë se 30 (tridhjetë) dite nga marrja në dorezim e punimeve, ku 5% e sigurisë së kontratës do të mbahet deri perfundimin e periudhës 1 (nje) vjecare të garancisë së punimeve.

Neni 3: Drejtuesi i Projektit

3.1 Drejtuesi i Projektit do të jetë: _____

3.2 Adresa/pika e kontaktit: _____

Neni 4: Kantieri

4.1 Kanteiri i Punëve do të jetë (Pershkrimi i saktë i venddodhjes së objektit që do të realizohet):

Neni 5: Data e Fillimit

5.1 Kontraktori do t'i jepet leja për të hyrë në kantiër më: _____. _____. 2019

Neni 6: Sigurimi

6.1 Nga Data e hyrjes deri në Afatin e Mbarimit kontraktori duhet të ketë siguracion që mbulon deri në shumën prej:

- Për dëmtime ose humbje të Punëve dhe Materialeve
- Për dëmtime ose humbje të Pajisjeve
- Për dëmtime ose humbje të pasurisë përveç Punëve, Materialeve dhe Pajisjeve
- Për dëmtime personal ose vdekje të personave në kantiër

Neni 7: Inspektimet dhe Testimet

7.1 Inspektimet dhe Testimet para vërtetimit të mbarimit të Punëve do të përfshijnë: Kontrollin periodik të punimeve të bëra nga Kontraktori.



7.2 Kjo kontratë do të emohet si një

- a Kontratë me Çmim Njësie të bazuar në çmimet e njësisë të shprehura në Preventivin në Njësi
- b Kontratë me Shumë Totale

Neni 9: Grafiku i Pagesës

9.1 Pagesa duhet bërë sipas grafikut të mëposhtëm: **Situacioni mujor (perfundimtar) te paraqitur nga Kontraktori.** Pagesa për Punët duhet bërë brenda 10 (dhjete) ditëve nga data që kontraktori paraqet një dokument që deklaron se objektivi për pagesën është arritur subjekt ky i konfirmimit të dokumentit nga drejtuesi i projektit. Nëse është lënë e paplotësuar, periudha kohore do të jetë 30 ditë.

9.2 Monedha e pagesës do të jetë LEKË. Nëse nuk është specifikuar, pagesa do bëhet me monedhën Shqiptare.

Neni 10: Pagesa Paraprake

10.1 Përqindja e pagesës paraprake do të jetë : s'ka pagesa paraprake. Nëse nuk është specifikuar, kontraktori nuk do të marrë pagesë paraprake.

10.2 Pagesa do të bëhet me monedhë Shqiptare.

Burimi i Financimit : Te ardhurat e veta

* Financimi për vitin 2019: -416 667 leke pa tvsh

* Financimi për vitin 2020: 5 658 259 leke pa tvsh

Nëse është priruar një pagesë paraprake, avanca do të paguhet brenda __ditëve nga marrja e sigurimit të kontratës.

10.3 Nëse jepet pagesa paraprake, shuma do të hiqet nga pagesa që duhet t'i jepet kontraktorit sipas formulës së mëposhtme: _____

Neni 11: Shërbimet në Lidhje me to

11.1 Kushtet e veçanta të mëposhme do të zbatohen për kryerjen e pagesës së shërbimeve të lidhura


Neni 12: Zbritja e garancisë së kontratës

12.1 Nëse parashikohet zbritje periodike të garancisë së kontratës ajo kryhet si më poshtë

Nëse nuk plotësohet, garancia mbetet e pandryshuar.

Autoriteti Kontraktor

BASHKIA ROSKOVEC
Emri dhe firma e Përfaqësuesit



Kontraktuesi Shoqeria

“BOSHNJAKU-B” -shpk
Emri dhe firma e Përfaqësuesit





REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA ROSKOVEC

Nr. ___ Prot.

Roskovec, me 07.02.2019

REF - Nr. 25 UP datë 07.02.2019

Lënda : "Dergohet njoftim për zhvillim tenderi në Bashkinë Roskovec"

AGJENCISE SE PROKURIMIT PUBLIK
TIRANE
(per botim)

BASHKIA ROSKOVEC

1. Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor

Emri Bashkia Roskovec
Adresa Roskovec
Tel/Fax: 0387 80 241
E-mail ardiejapi25@gmail.com
Faqja në internet www.bashkiaroskovec

2. Lloji i procedurës së prokurimit: Kerkese per propozim

1. Objekti i kontratës/marrëveshjes kuadër "Rikonstrukcion i rruges "Shkolla - Kërranjaket", fshati Luar, b=4m +2*0,5m bankine ".

4. Numri i referencës së procedurës/lotit : REF-06885-02-07-2019

5. Fondi limit 6 079 525 (gjashremilion e shtatedhete e nentemije e peseqind e njezet e pese) leke (pa tvsh).


Financimi i ndare si me poshte:

- per vitin 2019 = 416 667 leke pa tvsh
- per vitin 2020 = 5 662 858 leke pa tvsh

6. Kohëzgjatja e kontratës ose afati kohor për ekzekutimin: 3 muaj.

7. Afati kohor për dorëzimin e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje: 19.02.2019 ora 09:00

8. Afati kohor për hapjen e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje: 19.02.2019 ora 09:00



TYPULLI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

Majlinda BUFI



Nr. 48.09 Prod.
Dj. 16.08.2019



FONDI SHQIPTAR I ZHVILLIMIT
ALBANIAN DEVELOPMENT FUND

Dr. Studik
Seferi
Majlinda B...
19.08.2019

Nr. 1202 Pro



Tiranë, më 13/08/2019

Drejtuar: Bashkisë Roskovec
Lajja nr.1 Qendër, Roskovec

Lënda: Dërgim për firmosje i Marrëveshjes së Investimit

Në kuadër të bashkëpunimit me institucionin tuaj, bashkëngjitur po ju dërgojmë për firmosje Marrëveshjen e Investimit për objektin:


- Njërtimi i parkut agro-turistik dhe rehabilitimi rrugës hyrëse fshati Luar

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

Me respekt:

Dritan Adolli

Drejtor Ekzekutiv



MARRËVESHJE INVESTIMI

ndërmjet

Fondit Shqiptar të Zhvillimit

dhe

Bashkisë Roskovec

për

Objektin:

**“Ndërtimi i parkut agro-turistik dhe rehabilitimi
i rrugës hyrëse fshati Luar”**

TIRANË _____ **.2019**



Tabela e Përmbajtjes

Marrëveshje Investimi	3
Objekti i Marrëveshjes	3
Detyrimet e NJVV	3
Detyrimet e FSHZH	4
Realizimi i punimeve	5
Dorëzimi i objektit	5
Zgjidhja e Marrëveshjes para afatit të përfundimit të saj	6
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve	6
Komunikimi	7
Hyrja në fuqi	7



MARRËVESHJE INVESTIMI

Kjo Marrëveshje Investimi (MI), lidhet sot me datë _____.____.2019 ndërmjet:

Fondit Shqiptar të Zhvillimit (FSHZH), përfaqësuar nga Z. Dritan Agolli, Drejtor Ekzekutiv,

dhe

Bashkisë Roskovec (NjVV), e përfaqësuar nga Zj. Majlinda Bufi, Kryetar i Bashkisë.

Neni 1

Objekti i Marrëveshjes


- 1.1 Objekti i kësaj Marrëveshje është financimi i punimeve për realizimin e objektit: "Ndërtimi i parkut agro-turistik dhe rehabilitimi i rrugës hyrëse fshati Luar", si dhe përcaktimi i detyrimeve të NjVV-së:
 - (i) për lëshimin e Lejes së Ndërtimit;
 - (ii) për sigurimin e lejeve të tjera administrative të nevojshme për realizimin e projektit;
 - (iii) për përfundimin e çdo procedurë shpronësimi për interes publik duke siguruar financimin e plotë të kostove përkatëse të shpronësimit;
 - (v) për mirëmbajtjen pas realizimit të objektit.
- 1.2 Ky projekt financohet nga Buxheti i Shtetit programi: "Infrastruktura Vendore dhe Rajonale", në bazë të Ligjit nr. 99, datë 03.12.2018, për Buxhetin e Vitit 2019, Aneksi nr.3.
- 2.2. Projekti është aplikuar për financim nga Bashkia Roskovec me anë të shkresës nr. 251, datë: 22.01.2019, protokolluar në FSHZH me nr: 141, datë 23.01.2019.
- 2.3. Objekti është miratuar për financim me anë të vendimit nr: 184, datë:25.07.2019, të Këshillit Drejtues të FSHZH.
- 2.4. Fondi Shqiptar i Zhvillimit do të jetë agjencia e zbatimit të projektit.

Neni 2

Detyrimet e NjVV

NjVV duhet:

- 2.1. Të dorëzojë pranë FSHZH zyrtarisht projektin teknik të zbatimit me gjithë dokumentacionin përkatës për investimin e kërkuar.
- 2.2. Të miratojë projektin teknik të zbatimit pasi të jetë kontrolluar/rishikuar nga FSHZH.
- 2.3. Të realizojë Oponencën Teknike për projektin në rastet kur e parashikon ligji.
- 2.4. Të garantojë se nuk ka konflikt juridik dhe/ose social që lind nga pronësia mbi sheshin e ndërtimit ku do të zbatohet projekti.



- 2.5. Të marrë përsipër përgjegjësinë për zgjidhjen e problemeve juridike dhe/ose sociale që lindin nga pronësia mbi truallin dhe çdo lloj problemi tjetër të mundshëm që pengon zbatimin e punimeve.
- 2.6. Të realizojë, përpara fillimit të punimeve të ndërtimit, procesin e shpronësimit dhe të marrjes në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik, në përputhje me ligjin shqiptar.
- 2.7. Të marrë përsipër që në çdo konflikt të mundshëm gjyqësor që rrjedh nga zbatimi i objektit të kësaj marrëveshjeje, NjVV-ja të futet në pozitën procedurale të të paditurit në vend të FSHZH-së, sipas nenit 184 të KPrC-së.
- 2.8. Të lëshojë Lejen e Ndërtimit me zhvillues "NJVV", duke sjellë përjashtimin e NJVV-së dhe FSHZH-së nga detyrimi për të paguar taksën e ndikimit në infrastrukturë, në aplikim të nenit 46/3 të ligjit 107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit".
- 2.9. Të hartojë Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (VNM) dhe të respektojë kushtet e mbrojtjes së mjedisit në përputhje me legjislacionin shqiptar.
- 2.10. Të sigurojë Autorizimin ose Lejen Mjedisore duke mbuluar financiarisht tarifën përkatëse si dhe të sigurojë të gjitha lejet e tjera administrative kundrejt mbulimit financiar të kostove përkatëse, të cilat janë të nevojshme konform legjislacionit shqiptar.
- 2.11. Të dorëzojë sheshin e ndërtimit të projektit firmës zbatuese të punimeve brenda një afati prej 15 ditësh pas firmosjes së kontratës me firmën zbatuese të punimeve.
- 2.12. Të monitorojë zbatimin e projektit teknik, konform legjislacionit në fuqi.
- 2.13. Të marrë përsipër mirëmbajtjen dhe funksionimin e objektit pas marrjes përfundimtare në dorëzim të punimeve.
- 2.14. Të shkëmbejë informacion, në kuadër të kësaj marrëveshjeje, me FSHZH dhe supervisorin e punimeve me qëllim rimbartëvajtjen e këtij investimi.
- 2.15. Të pranojë se në rast të mosrespektimit të këtyre rregullave dhe dispozitave të kësaj Marrëveshjeje, humbet të drejtën e përfitimit të një investimi të ri nga FSHZH, për një periudhë të përcaktuar nga FSHZH.

Neni 3 Detyrimet e FSHZH

FSHZH merr përsipër:

- 3.1. Të financojë punimet për zbatimin e projektit pas firmosjes së kësaj Marrëveshjeje, deri në masën e financimit të miratuar nga Këshilli Drejtues dhe kontratës së nënshkruar midis FSHZH dhe Operatorit/operatorëve ekonomik.
- 3.2. Të financojë kostot për supervizionin dhe kolaudimin e punimeve, sipas kontratave përkatëse të nënshkruara me operatorët ekonomik.
- 3.3. Të kryejë prokurimin e punimeve, shërbimeve të supervizionit dhe kolaudimit në përputhje me legjislacionin shqiptar.
- 3.4. Të ndjekë realizimin e projektit në përputhje me standartet teknike, mjedisore, sociale dhe financiare.



- 3.5. Të dorëzojë NJVV projektin e zbatuar sipas faktit pas përfundimit të periudhës së garancisë së difekteve.

Neni 4 Realizimi i punimeve

- 4.1. Projekti i përcaktuar në pikën 1.1 të nenit 1, konsiston në:

- Rikonstruksimin e rrugës Vidhish-Luar me një gjatësi 1900 ml.
- Rikonstruksimin e rrugës Shkolla - Pylli i Luarit me gjatësi 290 ml.
- Ndërtimin e fushave mini-futbolli.
- Ndërtimin e një sheshi për panairë i cili do të shtrohet me pllaka guri.
- Ndërtimin e pedonaleve dhe vendosjen e stolave brenda në pyll.

- 4.2. Këto Punime do të realizohen në përputhje të plotë me projektin teknik të zbatimit, pasi është kontrolluar/ rishikuar nga FSHZH-ja.

- 4.3. FSHZH ka të drejtë të miratojë ndryshimet nga projekti fillestar i zbatimit vetëm pasi Supervizori e kërkon zyrtarisht këtë ndryshim. Në të tilla raste Supervizori paraqet dokumentacionin e plotë teknik i cili justifikon ndryshimet e propozuara.

- 4.4. Projekti do të zbatohet në përputhje me periudhën e përcaktuar në kushtet e Kontratës së Punimeve.

- 4.5. NjVV ka të drejtë të inspektojë punimet gjatë gjithë periudhës së realizimit të tyre. Çdo vërejtje objektive nga NJVV do të merret në konsideratë gjatë periudhës së zbatimit të projektit, deri në momentin e kolaudimit të tij. Pas kësaj periudhe vërejtjet quhen të ezauruara edhe nëqoftëse nuk janë bërë.


Neni 5 Dorëzimi i objektit

- 5.1. Pas njoftimit zyrtar nga supervizori për përfundimin e punimeve brenda një afati prej 30 (tridhjetë) ditë dorëzohet dosja teknike e objektit të zbatuar në dy kopje në FSHZH. FSHZH, nje kopje te dosjes teknike te objektit te zbatuar, ia dergon zyrtarisht NJVV.

- 5.2. FSHZH i vë në dispozicion Kolaudatorit dosjen teknike te objektit të zbatuar për të kryer kolaudimin e punimeve të këtij objekti që finalizohet me Aktin e Kolaudimit.

- 5.3. FSHZH cakton gjithashtu datën e inspektimit në terren dhe njofton zyrtarisht NJVV, Kontraktorin dhe Mbikqyrësin e Punimeve për të kryer inspektimin në objekt me qëllim Marrjen në Dorëzim të Përkohshëm të këtij objekti. Njoftimi bëhet minimalisht 15 (pesëmbëdhjetë) ditë kalendarike para kryerjes së Aktit të Kolaudimit. dhe përkon me datën e kolaudimit.

- 5.4. Në rastin kur NjVV-ja, në afatin e caktuar në pikën 5.3. për realizimin e inspektimit (kontrollit) në terren nuk merr pjesë në inspektim/kontroll dhe refuzon nënshkrimin e Çertifikatës së Marrjes së Përkohshme në Dorëzim pa dhënë arsye objektive me shkrim,



atëherë objekti do të quhet i marrë në dorëzim të përkohshëm nga NJVV-ja dhe kjo çertifikatë do të konsiderohet e vlefshme.

- 5.5. Periudha e Garancisë së punimeve të objektit do të jetë 2 (dy) vite kalendarike, duke filluar nga data e kryerjes së Aktit të Kolaudit.
- 5.6. NJVV ka të drejtë të njoftojë FSHZH për çdo problematikë apo defekt që mund të konstatojë gjatë gjithë periudhës së garancisë së punimeve.
- 5.7. Minimalisht 15 (pesëmbëdhjetë) ditë përpara përfundimit të Periudhës së Garancisë së Punimeve, FSHZH njofton zyrtarisht NJVV, Kontraktorin, Kolaudatorin dhe Mbikqyrësin e Punimeve për të kryer inspektimin (kontrollin) në objekt me qëllim Marrjen në Dorëzim Përfundimtar të këtij objekti. Nëse konfirmohet se nuk ka defekte ose/dhe defektet janë riparuar, do të firmoset Çertifikata e Marrjes Përfundimtare në Dorëzim të Punimeve.
- 5.8. Në rastin kur NJVV-ja, në afatin e caktuar në pikën 5.7. për realizimin e inspektimit (kontrollit) në terren nuk merr pjesë në inspektimin/kontrollin e përcaktuar dhe refuzon nënshkrimin e Çertifikatës së Marrjes Përfundimtare në Dorëzim pa dhënë arsye objektive me shkrim, atëherë objekti do të quhet i marrë në dorëzim përfundimtar nga NJVV-ja dhe kjo çertifikatë do të konsiderohet e vlefshme.
- 5.9. Me nënshkrimin e Çertifikatës së Marrjes Përfundimtare në Dorëzim, pavarësisht se NJVV-ja nuk mund të jetë e pranishme, objekti kalon zyrtarisht nën administrimin dhe inventarin e NJVV-së.

Neni 6

Zgjidhja e Marrëveshjes para përfundimit të afatit të saj

Në rast të pezullimit apo anulimit të fondeve nga Buxheti, me të cilat financohet ky projekt, do të pezullohen apo anulohen sipas rastit edhe financimi i këtij investimi nga FSHZH dhe kjo Marrëveshje do të zgjidhet pa penalitete.

Neni 7

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

- 7.1. NJVV dhe FSHZH do të bëjnë çdo përpjekje për të zgjidhur miqësisht me negociata direkte informale çdo mosmarrëveshje ose konflikt që mund të kenë midis tyre për çfarë lidhet me këtë Marrëveshje.
- 7.2. Nëse pas tridhjetë ditësh nga fillimi i negociatave informale konflikti nuk zgjidhet, mund të angazhohet një palë e tretë e pavarur për ndërmjetësim (p.sh. juristi i Prefekturës ose Qarkut), për zgjidhjen e tij. Në rast se edhe pas këtyre negociatave, konflikti nuk zgjidhet, palët do t'i drejtohen Gjykatës e cila ka kompetencën territoriale dhe lëndore për zgjidhjen e tij.
- 7.3. Palët e kësaj Marrëveshje njohin dhe pranojnë që çdo gjykim do të bëhet duke u bazuar në kushtet dhe kërkesat e kësaj Marrëveshje.



Neni 8
Komunikimi

Komunikimi midis palëve do të jetë i vlefshëm vetëm kur bëhet me shkrim.
Një njoftim do të jetë i vlefshëm vetëm pasi të ketë mbërritur në destinacionin e tij.

Neni 9
Hyrja në fuqi

Kjo marrëveshje hyn në fuqi në datën e nënshkrimit nga të dyja palët.

Drejtori Ekzekutiv i FSHZH

Dritan AGOLLI

Emër, Mbiemër, Firmë, Vullë



Kryetari i Bashkisë Roskovec

Majlinda BUFI

Emër, Mbiemër, Firmë, Vullë

